



f34

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASENIT UJOR ERZEN

Nr. 18/g prot  
dt. 08.01.2025

**VENDIM**

Nr.15, datë 23/12/2024

**PËR**

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR PËRDORIM BURIMI  
UJOR NËNTOKËSOR (PUS-SHPIMI) PËR QËLLIME TË  
NDRYSHME, TË SUBJEKTIT "ZASHA" SH.P.K**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, "Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Ujor Erzen,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e kërkesës për leje të shoqërisë "ZASHA" sh.p.k, "Kërkesë për leje për përdorim të burimit ujor nëntokësor për qëllime të ndryshme" (në nyen e grumbullimit të materialit të kromit), me vendndodhje, Bisht Kamëz, Bashkia Durrës.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Koordinatat e vendndodhjes së pus-shpimit (KRGJSH)

-X= 454482.5;      Y= 4582986.9;      Z= 0.5 m

Prurja e ujit të kërkuar:  $Q= 0.3$  l/sek

Prurja mesatare e ujit:  $Q= 0.32$  l/sek

Thellësia e pus-shpimit: 53 m

Thellësia e vendosjes së pompës : 40 m

Koordinatat e pikës së shkarkimit në kanal in e kullimit Fshati Vrinas (KRGJSH)

-X= 454454.3;            Y= 4582907.2;            Z= 0 m

3. Burimi ujqor të përdoret vetëm për qëllimin e kërkuar (për qëllime industriale në nyen e grumbullimit të materialit të kromit), dhe të mos përdoret për larje të inerteve lumore nëse subjekti nuk ka një leje aktive të shfrytëzimit të këtyre të fundit.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektit.

**KRYETARI I KBU ERZEN**

**AFRIM QËNDRO**



The image shows a handwritten signature in blue ink that overlaps a circular official stamp. The stamp is also in blue ink and contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRIE-SH' and 'KESHILLI I VIKUMIT UJOR' around the perimeter. In the center of the stamp, there is a smaller emblem or logo.